

Autoriteti i likuidimit për NSH "Tregu" publikon këtë:


NJOFTIM PËR ZGJATJEN E AFATIT

Njoftim për zgjatjen e afatit për aplikim në shpalljen publike të datës 22.01.2024 për 1 pozitë për vendin e punës Mbikëqyrës i Ofruesve të Shërbimeve të Sigurimit Fizik të NSH "Tregu" me Nr. të referencës 22012024.

Afati për aplikim zgjatet për shkak se numri i aplikacioneve të pranuar nuk ka qenë i mjaftueshëm.

Afati zgjatet edhe për 15 ditë përkatësisht shpallja mbetet e hapur deri me datë 20.02.2024 në ora 16:00.

Nënshkrimi



Autoriteti i Likuidimit për NSH "Tregu"

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Në bazë të nenit 3, paragrafi 2 të Rregullores nr. 06/2020 angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), Autoriteti i Likuidimit shpallë këtë:

Konkurs per Ofrues të Shërbimeve në procesin e likuidimit

Titulli i pozitës së punës	OSH Mbikëqyrës i Ofruesve të Shërbimeve të Sigurimit Fizik të NSH “Tregu”
Kohëzgjatja e emërimit	6 mujor
Paga (bruto) përfshirë kontributet e punëdhënësit	365.00 Euro
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	22.01.2024
Afati për aplikim	26.01.2024
Institucioni	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Departamenti	Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Operative
Divizioni	Zyra Rajonale Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit i PRN104 NSH Tregu
Vendi i punës	NSH “Tregu” -Tregjet e Prishtinës
Nr. i Referencës	22012024

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Ofruesi i shërbimeve do të punojë në pozitën e Mbikëqyrës i të gjithë Sigurimit fizik për NSH “Tregu” – tregjet e Prishtinës.
- Kontrolla e Sigurimeve: mbikëqyr aktivitetet ditore të Ofruesve të Shërbimeve të angazhuar si Sigurim Statik dhe Levizes, siguron dhe vlerëson efektivitetin në kryerjen e detyrave të tyre ditore, i raporton Udheheqesit të Ofruesve të Shërbimeve dhe sipas nevojës Zyratrit të Rasti lidhur aktivitet ditore në Tregun përkatës.
- Obligohet të ruaj dhe të mbrojë pasurinë e Tregut.
- Të informoj menjëherë mbi shkeljet apo veprat penale për të cilat ai merr dajeni.
- Të raportoj cdo informatë të marrë e cila ka lidhje me kryerjen më parë ose për përgaditjen për të kryer një vepër penale.
- Të informoj menjëherë mbikëqyrësin nëse ndaj tij ka filluar ndonjë procedim penal.
- Të raportoj tek mbikëqyrësi cdo ankesë të marrë në lidhje me sjelljen e një punonjësi tjetër të Tregut.
- Të mos mungoj në shërbim/punë apo të largohet nga vendi i shërbimit pa lajmërimin e mbikëqyrësit.
- Ofruesi i shërbimeve i caktuar në këtë pozitë i kryen punët dhe detyrat shtesë sipas kërkesës së mbikëqyrësit të drejtpërdrejt.

• 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimitimi i kërkuar: Shkolla fillore apo e mesme.

4. Kërkesa specifike

- Përvoja në punë/aktivitet të ngjashëm si dhe ish punëtorët e kësaj NSh-je me përvojë të ngjashme do të konsiderohet përparësi.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Aplikacioni i punësimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);
- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Vërtetimin nga Policia e Kosovës se ka/nuk ka dosje penale në sistemin informativ të Policisë së Kosovës;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, si dhe
- çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion.

6. Mënyra e Aplikimit

- Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar më së largu me datë 20.02.2024 në ora 16:00 në emalin punesimi@pak-ks.org.

7. Data e shpalljes së rezultateve të vlerësimit përfundimtar

- Lista e kandidateve sipas vlerësimit përfundimtar, do të shpallet më së largu deri më datën 27.02.2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>).

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes kontakt telefonit, SMS dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>)
-